

VENDIM
Nr.4, datë 19.1.2007

PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA “HCA”
SHPK PËR PERIUDHËN 1 JANAR 2006 - 31 DHJETOR 2006

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “b”, 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe vendimit nr.60, datë 29.12.2004 të Bordit të Komisionerëve “Për miratimin e të dhënave bazë në lidhje me aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël”, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 19.1.2007, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga “HCA” sh.p.k. për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për periudhën 1 janar 2006-31 dhjetor 2006,

VENDOSI:

1. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga “Hydroelectric Company of Albania” sh.p.k., për periudhën 1 janar 2006- 31 dhjetor 2006, të jetë 5,2 lekë/kWh.
 2. Ngarkohet “HCA” sh.p.k, dhe KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta